



Pranim / Dorezim / Prilpjen / Protokoll / Receival / Delivery	06.05	2022	2	viti / god / year
Organ / Agjencia / Organ / Jedinita / Org. Unit	Br. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SI/M/SH/CK	2662/2022		116	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.291/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë ng : Ardita Haxhnikaj Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.291/2021 të datës 28.03.2022 të pashtuar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Ministria e Zhvillimit Rajonal, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nenparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 06.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.291/2022 e datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoll 347 i datës 14.03.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 28.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1623/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës për mos përzgjedhje në Konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 31.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje

në ankesë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa kjo e fundit me datë 08.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1968/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:

Ankesën me numër të protokollit 1623/2022 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00008133 i datës 09.02.2022 për pozitën Zyrtar i Larte për Buxhet dhe Financa; Njoftimin e datës 01.03.2022; Emalin e datës 03.03.2022; Emalin e datës 03.03.2022; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 03.03.2022; Vërtetimin Nr.13-113/01-0047660/21 të datës 14.06.2021; Akt emërimit të datës 01.12.2012 të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1768/2022 të datës 31.02.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1968/2022 të datës 08.04.2022; Vendimin me numër protokollit 265 të datës 25.02.2022; Njoftimin e datës 21.02.2022; Njoftimin e datës 01.03.2022; CV-n e kandidatës së bashku me dokumentacionin përcjellës: Diplomën me numër Nr.1078 të datës 30.12.2016, Diplomën me numër Nr.3633 të datës 15.03.2011 Diplomën për kryerjen e shkollës së mesme të lartë Gjinnazit; Certifikatën Nr.304/2021; Certifikatën e datës 26-29.01.2017; Certifikatën me Nr.178/2016 të datës 12.10.2016; Certifikatën e datës 23.04.2015; Certifikatën me numër 016-2013 të datës 26-26.01.2013; Certifikatën me numër 52 të Dhjetorit 2017; Certifikatën me numër PK/KP/CIV ID/ 1572 të datës 10.09.2012; Certifikatën me numër 179/2012 të datës 30.07.2012; Certifikatën me numër 175/2012 të datës 23.07.2012; Certifikatën me numër 205/2012 të datës 25.09.2012; Certifikatën e datës 07-08.03.2012; Certifikatën 14.06.2010-31.8.2010; Letër referencën e datës 11.04.2012; Akt emërimit të datës 03.04.2012; Letër referencën e datës 06.07.2015; Dokumentacionin e identifikimit; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtues i mesëm i ulet dhe profesionale të datës 15.01.2022; Vendimin me numër Reference 07/1-01SAP-P/4173; Vërtetimin me numër reference 07/1-01SAP-P/0719; Cv e kandidatës së bashku me dokumentacionin përcjellës: Diplomën universitare të datës 26.05.2021; Diplomën me numër të protokollit 298 të datës 06.06.2005; Certifikatën e datës 09.03-12.03.2018; Certifikatën me numër 44/2017 të datës 31.03.2017; Certifikatën e vitit 2015-2017; Certifikatën 229/20132 të datës 19.11.2013; Certifikatën e datës 23.10.2009; Certifikatën 07-08.06.2021; Certifikatën e datës 10.03.2009; Certifikatën 06.11.2007; Certifikatën me numër 044 të datës 01.02.2007; Certifikatën e datës 20.10.2009; Kontratën e punës nr.02/2008; Kontratën e punës me numër Ref. 014 të datës 06.08.2010; Kontratën e punës për kohë të pacaktuara me Nr.01-08/2011; Akt emërimit me numër Ref.AME 9/2013 të datës 03.01.2013; Akt emërimit me numër Ref.AME/DO 7/11 të datës 31.10.2011; Letër referencën e datës 15.08.2010; Dokumentin e identifikimit të Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike të datës 14.02.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike të datës 10.02.2022; Vendimin me numër 45/2020 të datës 10.07.2020 për pushim prindëror-Lehonisë; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 27.01.2020; Vërtetimin e datës 11.02.2022; Shkresën lidhur me përvojën e punës së kandidatës; CV e kandidatit së bashku me dokumentacionin përcjellës: Diplomën universitare me numër 232 të datës 14.11.2012; Diplomën me numër 1825 të datës 29.03.2006; Diplomën me numër të protokollit 3340 të datës 24.05.2002; Certifikatën e datës 28-29.05.2018; Certifikatën e datës 08.09.2015; Certifikatën e datës 18-19.01.2013; Certifikatën e datës 08.12.2010; Certifikatën (data e padukshme); Certifikatën e datës 16.11.2007; Vërtetimin me numër

31/05 të datës 15.09.2005; Vërtetimin me numër 64/019 të datës 01.11.2019; Vërtetimin me numër Nr 13-113/01-0047660/21 të datës 14.06.2021; Certifikatën e datës 08.12.2010; Letër rekomandimin të datës 07.10.2009; Dokumentin e identifikimit; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 01.12.2020; Vërtetimin me numër Ref.13-116/04-0047659/21 të datës 14.06./2021; Akt emërimi e datës 01.12.2012 , Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë e datës 15.06.2021; CV e kandidatës së bashku me dokumentacionin përcjellës: Diplomën Universitare me Nr.2059 të datës 15.06.20211; Diplomën universitare me Nr.731 të datës 25.05.2015; Certifikatën e datës 07.05.2015; Certifikatën me numër 100/2019 të datës 02.08.2019; Certifikatën me Nr.05-01/68/20 të datës 28.12.2020; Certifikatën e datës 18,19,24, dhe 26.11.2021; Kontratën e punës të datës 02.05.2011; Akt emërimit e datës 31.02.2019; Vendimin me numër 08/1 të datës 15.08.2019; Dokumentin e identifikimit; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe të nëpunësve te shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesionale të datës 26.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe të nëpunësve te shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesionale të datës 19.07.2021; Vërtetimin e datës 01.02.2022; CV e kandidatës së bashku me dokumentacionin përcjellës: Certifikatën e datës 12.04.2017; Certifikatën e datës 26-27.02.2015; Certifikatën e datës 17.12.2020; Certifikatën e datës 08-09-.12.2021; Certifikatën e datës 07.11.2021; Diplomën me numër 2433 të datës 29.01.2010; Diplomën me numër 009/15 të datës 10.12.2014; Certifikatën me numër 2013026 të datës 14.03.2013; Certifikatën e datës 13-15.04.2012; Certifikatën e datës 03-06.03.2011; Certifikatën e datës 30.09.2010; Certifikatën e datës 22-23.03.2001; Letër referencën e datës 14.11.2011; shkresën e muajit Mars, 2009; Letër konfirmimin me numër të protokollit 700/3149 të vitit Maj 2015; Kontratën e punësimit të datës 15.07.2010; Kontratën e Punësimit të datës 13.07.2011; Akt emërimit e datës 15.07.2012; Dokumentin e identifikimit; CV e kandidatit së bashku me dokumentacionin përcjellës: Diplomën me numër 299 të datës 20.09.2019; Certifikatën me numër 59/2016 të datës 16.03.2016; Certifikatën e datës 10.02.2017; Certifikatën e datës 23.09.2021; Certifikatën e datës 23.09.2021; Akt emërimit 05.01.2015; Certifikatën e datës 04.05.2011; Certifikatën e datës 14.12.2012; Dokumentacionin e identifikimit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.12.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 25.12.2021; Regjistri i kandidateve të ftuar për intervistë me gojë të datës 03.03.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve për pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa e datës 03.03.2022; Njoftimin e datës 14.03.2022; Akt emërimit e datës 01.12.2012; Ankesën e datës 07.03.2022; Vendimin me numër të protokollit 347 të datës 14.03.2022; Pyetjet për intervistën me gojë për pozitën të datës 03.03.2022; Vendimin me numër 08/1 të datës 15.08.2019; Vendimin me numër të protokollit 35 të datës 12.01.2021; Vendimin me numër të protokollit 02 të datës 10.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se është e pabazuara ankesa e ankuesit **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Zhvillimit Rajonal (me tejt MZHR) me datë 25.01.2022 ka shpallur Njoftimin për Konkursin me numër Reference RN00008133 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, profesional 1, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Si kushte të veçanta për lëvizje brenda kategorisë janë përcaktuar: të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë

profesionale të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fund, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar; **Arsimin e kërkuar:** Diploma e studimeve universitare në Fakultetin Ekonomik me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diplomën Master të jetë e njëjta apo vazhdim i diplomës Bachelor. **Përvoja e punës:** se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës.

Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 09.02.2022 deri me datë 16.02.2022, dhe interesim konkurrimi kanë shprehur 6 kandidatë. Sipas Verifikimit paraprak të Njesisë së Burimeve Njerëzore katër kandidatë dhe kanë plotësuar kushtet sipas konkursit duke u përfshirë në listën e ngushtë, ndërsa dy nga kandidatët dhe u është refuzuar aplikacioni për arsye se të njëjtit nuk kanë plotësuar kushtet për këtë pozitë. Pas zhvillimit të fazës së vlerësimit me gojë, Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë me datë 03.03.2022 ka përgatitur listën e renditjes përfundimtare sipas së cilës kandidatja është vlerësuar si kandidatja më e vlerësuar me gjithsej 75 pikë, ndërsa ankuesi si kandidati i dytë me gjithsej 65 pikë.

Më datë 03.03.2022 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të MZHR-së ka publikuar Njoftimin mbi kandidatin e suksesshëm sipas të cilit është shpallur si kandidatja fituese për pozitën *Zyrtare e lartë për buxhet dhe financa* sipas Konkursit me numër Reference RN00008133.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin përfundimtar, me datë 07.03.2022 parashtron ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër të protokollit 347 të datës 14.03.2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lenë në fuqi Vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë të datës 03.03.2022.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit për të qenë kandidati i përzgjedhur, vlerësimi ka qenë jo korrekt dhe jo i drejtë nga ana e Komisionit Vlerësues dhe se kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojë pune në fushën e buxhetit dhe financave, kështu që janë bërë shkelje ligjore nga Komisioni i Vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit së kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojë profesionale nga lëmia e buxhetit dhe financave, Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatës tani kandidate fituese, ka konstatuar së e njëjta sipas Diplomës me Nr.2059 të datës 16.01.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ka përfunduar më datë 15.06.2011 Fakultetin Ekonomik dhe ka marrë titullin Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet, me gjithsej 18 kredi/ECTS, ndërsa sipas Diplomës më Nr.731 të datës 01.06.2015 ka përfunduar studimet master për Banka, Financa dhe Kontabilitet me total 120 kredi/ECTS, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës Kolegji ka gjetur se e njëjta sipas Akt Emërimit të datës 21.02.2019 është emëruar Zyrtare për Zhvillim Socio Ekonomik, kurse sipas Vendimit më numër protokollit 0321 të datës 15.08.2019 dhe Vendimit me numër protokollit 35 të datës 12.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së, kandidatja është caktuar dhe ka ushtruar edhe detyrat e Zyrtarit Shpenzues nga data 15.08.2019 e tutje dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson së kandidatja përzgjedhur ka plotësuar kriterin e arsimit dhe

përvojës lidhur me pozitën *Zyrtare e lartë për buxhet dhe financa*, sipas konkursit me numër Reference RN00008133.

Po ashtu Kolegji ka gjetur së kandidatja fituese ka përmbushur të gjitha kërkesat për lëvizjen brenda kategorisë, pasi që sipas Akt emërimit të datës 21.02.2019 pozita *Zyrtare për Zhvillim Socio Ekonomik* është pozitë profesionale 1 dhe e konfirmuar me vet lëshimin e Akt Emërimit si me lartë; sipas vërtetimit të datës 01.02.2022 të Menaxheres së Personelit të MZHR-së, nuk ka masë disiplinore dhe se ndaj të njëjtës nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore; dhe së për vitin 2020 dhe 2021 lidhur me rezultatet e punës është vlerësuar me notë *shumë mirë* gjegjësisht për vitin 2020 me notë të përgjithshme 4.2 ndërsa për vitin 2021 me notë 4.4.

Po ashtu, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se edhe ankuesi ka plotësuar kërkesat formale për pozitën e shpallur duke u përfshirë në listën e ngushtë dhe në fazat tjera të vlerësimit mirëpo bazuar në vlerësimin e Komisionit Vlerësues kandidatja është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej 75 pikë duke u renditur si kandidatja e parë në Listën Përfundimtare të datës 03.03.2022, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 65 pikë duke u renditur si kandidati i dytë, kështu që mbi këto arsye rrjedhë se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: *1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëmrisht.*

Përkitazi me pretendimin ankimor se vlerësimi ka qenë jo korrekt dhe jo i drejtë nga ana e Komisionit Vlerësues, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës, nuk ka hasur në ndonjë dëshmi që provon së Komisioni Vlerësues ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe jo real të ankuesit, andaj, mbi këtë bazë rezulton së është i pa qëndrueshëm ky pretendim ankimor.

Nisur nga gjendja faktike dhe ligjore të konstatuara si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson së organi i punësimit, përkatësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të MZHR-ës ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë ka vepruar në pajtim me nenin 47, 48 dhe 49 të Rregullores (QRK) NR.16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, nisur si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në*

Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.291/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Prodesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.